

STATUTI

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " TIRANA AIRPORT SHUTTLE" SHPK

KREU I

EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

Neni 1 – Emertimi dhe forma Ligjore e Shoqerise

1.1 Emri I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte "TIRANA AIRPORT SHUTTLE" Sh.p.k. (ne vijim "Shoqeria").

1.2 Shoqeria TIRANA AIRPORT SHUTTLE Sh.p.k. themelohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar dhe rregullohet prej ketij statuti dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

1.3 Emri i shoqerise mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

1.4 Shoqeria ka vulen dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 - Selia

2.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Tirane Rruga Mine Peza, Ndertesa nr.68, Shk.1, Apartamenti 1, Zona Kadastrale 8330, Tirane. 1001.

2.2 Asambleja e Pergjithshme mund te hapi, transferoje dhe/apo mbylle, si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj, dege dhe/ose zyra perfaqesimi. Ndersa, Administratori i Shoqerise mund te hapi, transferoje dhe/apo mbylle, si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj, seli sekondare dhe/ose filiale.

Neni 3 – Kohezgjatja

3.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore me afat te pacaktuar.

3.2 Shoqeria mund te priset ne cdo moment me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Neni 4 – Objekti i Shoqerise

4.1 Transport rrugor nderkombetar te udhetareve. Transport rrugor brenda vendit te udhetareve. Agjenci udhetimi. Operator Turistik. Kryerja e sherbimeve te rregullta te specializuara te transportit te udhetareve brenda vendit. Agjenci transporti nderkombetar te udhetarve. Agjenci transporti udhetarsh me autobus dhe taksi brenda vendit. Transport rrugor te mallrave per vehte dhe per te trete brenda dhe jashte vendit, tregeti me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industrial dhe ushqimore, import dhe eksport i tyre. Organizim eventesh. Veprimtari turistike si agjenci turistike udhetimi per kryerjen e sherbimeve dhe udhetimeve turistike me turistete te huaj dhe vendas, individe ose te organizuar ne grupe, brenda dhe jashte vendit. Sherbime sipas guidave te udhetimit, prenotim dhe akomodim hoteli. Sherbime te dhenieve me qera te mjeteve me dhe pa drejtues te mjeteve. Agjenci Imobiliare, sherbime ndermjetesimi, Aktivitet ne fushen e pasurive te patundshme, vleresimin e pasurive te patundshme, te angazhohet ne shitjen me shumice dhe pakice te cdo lloj pasurie, Ndermjetesim ne fushen e qeramarrjes dhe qeradhenies se automjeteve. Kompani teknologjike per ndertimin e webeve, aplikacioneve, Web Design, Menaxhim rrjetesh etj.

KREU II

KAPITALI, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE TE SHOQERISE

Neni 5 – Kapitali I Shoqerise, kontributet dhe kuotat

" TIRANA AIRPORT SHUTTLE " SHPK ("Shoqeria") eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 (njeqind mije) leke, i ndare ne 2 (kuota) me vlere minimale 50,000 (pesedhete mije) leke/ kuota te cilat zoterohen nga ortaket e saj si ne vijim:

- i. Z. Donald Merdanaj, shtetas shqiptar, lindur ne Greshice dhe banues ne Tirane, me 01.04.1995, me nr. personal J50401128A ortak zoterues I nje kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise ; dhe
- ii. Z. Vilson Merdanaj, shtetas shqiptar, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, me 06.04.1986, me nr. Personal I60406056B ortak zoterues I nje kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise ;

Neni 6 – Zmadhimi dhe Zvogelimi I kapitalit te Shoqerise

6.1 Rritja e kapitalit mund te kryhet me vendim te Asamblese, kurdo dhe per me shume se nje here, permes kontributit ne para apo ne natyre apo me kredi, ne zbatim te dispozitave ligjore.

6.2 Rritja e kapitalit konsiderohet e kryher ne momentin kur kuotat e emetuara dhe te nenshkruara me pare jane shlyer teresisht.

6.3 Zvogelimi i kapitalit te Shoqerise mund te kryhet me vendim te Asamblese, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi. Ne cdo rast kapitali i Shoqerise nuk mund te zvogelohet nen minimumin e parashikuar me ligj.

6.4 Zvogelimi i kapitalit mbartet prej secilit ortak proporcionalisht me kuotat qe ai ka ne kapitalin e Shoqerise.

Neni 7– Transferimi i kuotave te shoqerise

7.1 E drejta e pronesise mbi kuotat eshte lirisht e transferueshme tek te tretet ne perputhje me dispozitat e Ligjit nr.9901, date 14.03.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", I ndryshuar.

7.2 Ndalohet krijimi i te drejtave reale mbi kuotat e Shoqerise me qellim garantimin e detyrimeve te nje pale te trete, me ose pa pagese, pervecse kur me vendim te Asamblese se Pergjithshme parashikohet ndryshe.


KREU III

ADMINISTRIMI

NENI 8 – Administrimi I Shoqerise

Organi me i larte vendimarrës i Shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve. Vendimet kryesore te veprimtarise se Shoqerise merren me vendim te Asambleja e Ortakeve, e cila ka te drejten te miratoje vendime ne lidhje me te gjitha ceshtjet e aktivitetit te saj.

Konkretisht Asambleja, ka kompetenca per te vendosur per ceshtjet e meposhtme:



- a. ndryshimin e Statutit;
 - b. rritjen dhc zvogelimin e kapitalit te shoqerise;
 - c. pranimin e ortakeve te rinj dhe transferimin e kuotave;
 - d. bashkimin, ndarjen, transferimin, riorganizimin, shperberjen dhe cdo transferim tjetër te Shoqerise;
 - e. blerjen, shitjen ose dhenien me qira te pasurive te paluajtshme te Shoqerise;
 - f. emerimin dhe shkarkimin e Administratorit/eve,;
 - g. miratimin e raporteve vjetore;
 - h. miratimin e bilancit
 - i. shperndarjen e fitimeve
 - j. kerkon dhenien e kredive, hipotekave dhe/ ose dhenia e garancive.
- k.per te gjitha ceshtjet e tjera te cilat nuk parashikohen shprehimisht ne kete statut dhe qe I takojne ortakeve sipas ligjit per shoqerit tregetare.

Vendimet e Asamblese merren ne baze te kerkesave te kourumit dhe shumices perkatese te parashikuara nga ligji per shoqerist tregetare.

NENI 9 – Administratori/et

9.1 Administrimi i Shoqerise i caktohet nje administratori, per nje periudhe 5 (pese) vjecare, me te drejte rizgjedhje. Ortaket kane te drejte te emerojne, apo shkarkojne ne cdo kohe administratorin.

9.2 Si Administrator I shoqerise emerohet:

Z. Donald Merdanaj, shtetas shqiptar, lindur ne Greshice dhe banues ne Tirane, me 01.04.1995, me nr. personal J50401128A, shtetas Shqiptar, madhor e me zotesi te plote per te vepruar.

NENI 10 - Te drejtat e Administratorit/et

Administratori ushtron individualisht te drejtat e plota te caktuara per administrimin e Shoqerise dhe ka te drejten te miratoje vendimet qe gjykohen te drejta per arritjen dhe realizimin e objektit te Shoqerise, me perjashtimin e veprimeve qe me kete statut apo me ligj I jane rezervuar ortakeve.

Veprimet e meposhteme perfshihen ne aktet e administrimit te zakonshem:

- a. perfaqesimin e Shoqerise kundrejt paleve te treta dhe organeve publike;
- b. hapjen e llogarive bankare te Shoqerise prane Institucioneve bankare
- c. perfundimi i kontratave ose marreveshjeve me palet e treta;
- d. nenshkrimin e te gjithë dokumentave, leshimin e faturave, transferimet, pagesen e detyrimeve te Shoqerise;
- e. punesimi, shkarkimi, percaktimi i pagave dhe shperblimeve te tjera dhe cdo vendim tjetër lidhur me stafin e Shoqerise, ne perpudhje me udhezimet e miratuara nga Ortaket;
- f. mbajtja e librave kontabel, sic parashikohet nga ligji dhe parimet e kontabilitetit.

g. pergatitja e pasqyrave financiare te Shoqerise dhe verifikimi i tyre nga auditore te jashtem, ne rast se kerkohet me ligj ose nga Ortaket;

h. cdo veprim tjetër qe sipas ligjit per Shoqerite tregtare i takon administratorit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

Administratori, me prokure te posacme mund t'i delegoje paleve te treta permbushjen e akteve te vetme ose kategori te akteve.

KREU IV

VITI FINANCIAR, PASQYRAT FINANCIARE VJETORE, NDARJA E FITIMIT

NENI 11 – Viti financiar dhe bilanci vjetor

11.1 Viti ushtrimor fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.

11.2 Viti i pare ushtrimor fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit, dhe perfundon me 31 Dhjetor, te te njejtit vit.

11.3 Pasqyrat financiare dhe raporti i ecurise i hartuar prej Administratorit miratohen prej Asamblese se Pergjithshme.

11.4 Miratimi i dokumenteve lidhur me vitin ushtrimor duhet te kryhet brenda 6 (gjashte) muajve nga perfundimi i vitit financiar

NENI 12 – Fitimet

12.1 Fitimet neto qe rezultojne nga pasqyrat financiare vjetore, pasi jane zbritur te gjitha shumtat qe Asambleja e Pergjithshme ka vendosur te vere menjane, i shpemdahen ortakeve te shoqerise

12.2 Asambleja, gjithashtu, mund te vendose te mbaje shuma te caktuara si rezerva, apo te shtyje shpemdargjen e fitimeve - teresisht apo pjeserisht — ne vitet ushtrimore pasardhes.

KREU V

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

NENI 13 – Shperndarja

13.1 Shoqeria shperndahet ne perfundim te afatit te saj parashikuar ne statut apo edhe perpara ketij afati, ne rastet e parashikuar nga ligji apo me vendim te Asamblese se Pergjithshme, me shumicen e parashikuar per modifikimin e Statutit te Shoqerise.

NENI 14 – Likuidimi

14.1 Ne rast shperndarje Shoqeria do te kaloje ne likuidim

14.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja e Pergjithshme do te emeruje nje apo me shume likuidatore, te cilet do te paraqesin raportin perfundimtar mbi gjendjen e pasivit dhe aktivitet te Shoqerise, mbi veprimet e likuidimit dhe kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.

14.3 Ne perfundim te procedures se likuidimit, Asambleja e Pergjithshme do te marre vendim ne lidhje me bilancin financiar perfundimtar, mbi vlefshmerine e punes se kryer prej likuidatorit dhe mbi perfundimin

e procedures se likuidimit. Pas shlyerjes se kreditoreve, likuidatori shperndan te ardhurat perfundimatare te likuidimit tek ortaket, ne propocion me kuotat qe zoterojne.

KREU V

DISPOZITAT E FUNDIT

NENI 15 – Zgjidhja e mosmarrveshjeve

15.1 Te gjitha mosmarrveshjet qe lindin nga ose ne lidhje me interpretimin ose zbatimin e ketyre dispozitave Statutore, midis ortakeve ose midis nje ose me shume ortakeve dhe Shoqerise, do te zgjidhen me marreveshje midis paleve te interesuara. Ne rast se nuk arrihet nje zgjidhje me marreveshje, palet do te mund t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 16 – Dispozitat ligjore ne fuqi

16.1 Per gjithcka qe nuk parashikohet ne kete Statut, zbatohen dispozitat ligjore ne fuqi.


NENI 17 – Gjuha

17.1 Ky statut hartohet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe.

Tirane, me 26 nentor 2023

ORTAKET E SHOQERISE

Z. Donald MERDANAJ



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Donald Merdanaj', with a large, stylized scribble below it.

Z. Vilson MERDANAJ



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Vilson Merdanaj', with a large, stylized scribble below it.